

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË INSPEKTORATIT TË LARTË TË DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË PASURIVE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe mbështetur punën e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, si një institucion i pavarur që merret me administrimin dhe kontrollin e deklarimit të pasurisë, të detyrimeve financiare dhe parandalimin e konfliktit të interesave, për subjektet e parashikuara në ligj;

- duke vlerësuar dhe përkrahur punën e këtij institucioni në luftën kundër korrupsionit;

- duke nxitur bashkëpunimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive me strukturat e tjera përgjegjëse për luftën kundër korrupsionit,

Konstaton se:

- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive ka dhënë rezultatet e para në luftën kundër korrupsionit dhe për parandalimin e konfliktit të interesave;

- ka marrë nismën dhe ka dëshmuar një vullnet të mirë për bashkëpunimin ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit dhe krimit ekonomik;

- ka zhvilluar trajnime me subjektet e parashikuara në ligj, në lidhje me zgjidhjen e konfliktit të interesave dhe deklarimin e pasurive;

- ka ushtruar kompetencat e tij për dhënien e masave administrative, në zbatim të ligjit, për personat që nuk e kanë dorëzuar në kohë deklarimin e pasurisë.

Kuvendi kërkon për vitin 2008:

- angazhimin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për zbatimin e plotë të legjislacionit për kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare, si edhe për parandalimin e konfliktit të interesave, në lidhje me sanksionet e parashikuara në këto ligje;

- forcimin e aftësive investiguese të institucionit;

- rritjen e bashkëveprimit me institucionet e tjera e në mënyrë të veçantë me prokurorinë, për sa i përket ndjekjes së denoncimeve të bëra, me qëllim kryesor parandalimin e korrupsionit dhe krimit ekonomik;

- futjen në raportin vjetor të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive për Kuvendin të vlerësimit për bashkëpunimin e vet me institucionet e tjera, që kanë detyrë ligjore të luftojnë krimin ekonomik;

- intensifikimin e punës njohëse dhe edukuese të subjekteve të deklarimit edhe nëpërmjet mediave, reklamave ose emisioneve të posaçme.

10 prill 2008